



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**“ISA BOLETINI”**

Nr. Prot: 22/12 ; Data: 03.10.2024

Senati i Universitetit “Isa Boletini në Mitrovicë, bazuar në kompetencat e përcaktuara në nenin 166, paragrafin 4 të Statutit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, si dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Udhëzimin Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 dt.11.03.2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe Rregullores me nr.prot.3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024 dhe me Vendimin e Senatit me nr.prot.1757 dt.06.08.2024 në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë në mbledhjen e mbajtur më 26.09.2024, vendosi të shpall:

## **KONKURS**

*Për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit “Isa Boletini”*

### **I. FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE**

**Zgjedhje për herë të parë në thirrjen përkatëse:**

1. Një mësimdhënës për lëndët: “Metalogjenia”, “Struktura e fushave xeherore”, “Hartografimi gjeologjik”, “Gjeologjia strukturore dhe tektonika”, “Petrologjia strukturore”.

**Avancime ose rizgjedhje:**

2. Një asistent për grup lëndësh nga Xehetaria.
3. Një asistent/e për lëndët: “Matematika I” dhe “Matematika II”
4. Një mësimdhënës për lëndët: “Fizika I” dhe “Fizika II” (Metalurgjisë), “Fizika e përgjithshme” (Xehetari) dhe “Fizika” (Gjeologji).
5. Një mësimdhënës për lëndët: “Grafika inxhinierike”, “Bazat e teknikës minerare”, “Mekanika e Shkëmbinjëve I” dhe “Mekanika e Shkëmbinjëve II”, “Gjeostatistika në miniera”.

### **II. FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE**

**Avancime ose rizgjedhje:**

1. Një mësimdhënës për lëndët: “Kimia analitike, ITU”, “Kimia analitike, T”, “Kimia e mjedisit”, “Metodat instrumentale në mbrojtjen e mjedisit”, “Trajtimi i ujërave të zeza I”, “Analiza instrumentale e produkteve ushqimore”.

2. Një mësimdhënës për lëndët: “Kimia Fizike”, “Kimia Fizike I” “Bazat e inxhinierisë së reaktorëve, ITU” “Bazat e inxhinierisë së reaktorëve, T”, “Përgatitja e ujit”, “Kapituj nga teknologjia e paketimit të ushqimeve”.
3. Një mësimdhënës për lëndët: “Bazat e Informatikës”, “Statistika në inxhinieri”, “Menaxhimi i hedhurinave”, “Softveri aplikativ në inxhinierinë mjedisore”, “Inxhinieria e mbrojtjes së mjedisit”, “Metodat statistikore dhe modelimi kompjuterik në shkencat e mjedisit”.
4. Një mësimdhënës për lëndët: “Fizika”, “Fizika I”, “Fizika II”, “Energjetika e proceseve në industri”, “Monitorimi i ndotjeve radioaktive”, “Transporti i materieve të rrezikshme”.
5. Një mësimdhënës për lëndët: “Biologji”, “Mikrobiologjia e përgjithshme”, “Biokimia e përgjithshme, ITU”, “Biokimia e përgjithshme, T”, “Gjenetika molekulare”.
6. Një mësimdhënës për lëndët: “Operacionet mekanike”, “Bilanci i materies dhe i energjisë”, “Reaktorët kimikë”, “Korrodimi dhe mjedisi”, “Metodologjia e punës kërkimore shkencore”, “Trajtimi i ujërave shkarkuese”.

### **III. FAKULTETI EKONOMIK**

#### **Avancime ose rizgjedhje:**

1. Një mësimdhënës për lëndët: “Menaxhmenti Financiar”, “Tregjet dhe institucionet financiare”, “Financat e Korporatave”, “Parimet e Kontabilitetit”.
2. Një mësimdhënës për lëndët: “Statistika Biznesore”, “Menaxhimi i Operacioneve”, “Analiza e të dhënave për hulumtime në biznes”, “Vendimmarrja Menaxheriale”.
3. Një asistent për lëndët: “Financa”, “Menaxhmenti financiar”, “Financat ndërkombëtare”, “Financat personale”, “Parimet e kontabilitetit”, “Kontabiliteti tatimor”, “Kontabiliteti menaxherial”, “Menaxhimi i portofolios së investimeve”, “Parimet e auditimit”, “Analiza e pasqyrave financiare”, “Financat publike”, “Qeverisja korporative”.

### **IV. FAKULTETI JURIDIK**

#### **Avancime ose rizgjedhje:**

1. Një mësimdhënës për lëndët: “Histori e institucioneve shtetërore juridike”, “Etika e së drejtës”, “E drejta penale”, “Kriminalistika”, “E drejta penale e avancuar”, “E drejta sportive”.
2. Një mësimdhënës për lëndët: “E drejta ndërkombëtare publike”, “E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, “E drejta e Bashkimit Evropian”, “Organizatat Ndërkombëtare”, “Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare”, “Tema të zgjedhura nga e drejta e Bashkimit Evropian”.

## V. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

### Zgjedhje për herë të parë në thirrjen përkatëse:

1. Një mësimdhënës për lëndët: “Përpunim me prerje I”, “Përpunim me prerje II”, “Dizajni dhe Analiza e Sistemeve Prodhuese”, “Teknologjitë e reja prodhuese”, “Metodat jokonvencionale të përpunimit”.
2. Një mësimdhënës për lëndët: “Automatizimi i Prodhimtarisë dhe Robotika”, “Programimi i makinave CNC”, “Teknikat Matëse”, “Rregullim Automatik”, “Softverët aplikativë”, “Bazat e Mekatronikës”.
3. Një mësimdhënës për lëndët: “Mikroprocesorët dhe mikrokompjuterët”, “Qarqet Kompjuterike”, “Bazat e Inxhinierisë Elektrike”, “Zhvillimi i Aplikacioneve Mobile”, “Modelimi dhe Simulimi Kompjuterik”, “Siguria e Informacionit”.
4. Një asistent për lëndët: “Bazat e shkencave kompjuterike”, “Sistemet e Bazës së të Dhënave”, “Menaxhimi i Bazës së të Dhënave”, “Siguria e të Dhënave”, “Siguria e Informacionit”, “Sistemet Operative”, “Web Programimi”, “Sistemet e Informacionit dhe Ndërmarrësia Digjitale”, “Modelimi dhe Simulimi Kompjuterik”, “Kurs Laboratorik”.

### Avancime ose rizgjedhje:

1. Një mësimdhënës për lëndët: “Fizika Inxhinierike - (SHKI)”, “Fizika Inxhinierike – (IE)”, “Fizika Inxhinierike – (MP)”, “Mekanika e fluideve – (MP)”.
2. Një mësimdhënës për lëndët: “Analizë financiare”, “Kontabilitet dhe Kosto”, “Aftësi Komunikuese”, “Auditim”, “Financat dhe Investimet”, “Kontabiliteti në IT dhe ERP”.
3. Një mësimdhënës për lëndët: “Interneti dhe Web Teknologjitë”, “Intelegjenca e Biznesit”, “Procesimi i Big Data”, “Web Programimi”, “Kurs Laboratorik”.

## II. Kushtet e përgjithshme

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për zgjedhjen e personelit akademik janë të përcaktuara në dispozitat e Statutit të UIBM, Rregullores nr.prot.3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik - e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024 dhe me Vendimin e Senatit me nr.prot.1757 dt.06.08.2024 në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë.

## III. Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- a) Kërkesën për aplikim
- b) Biografinë (CV);
- c) Çertifikatën/ekstraktin e lindjes;
- d) Kandidatët që janë punësuar në UIBM me rastin e konkurrimit për avancim në thirrjen akademike të profesorit asistent duhet të dorëzojnë diplomën origjinale të doktoratës ose kopjen e saj të vërtetuar nga noteri, ose vendimin për nostrifikimin (barasvlerën) e diplomës së doktoratës/dëshminë e aplikimit për nostrifikim. Kandidatët të cilët

konkurrojnë për riemërim në pozitën e asistentit, nëse nuk kanë doktoruar ende duhet të sjellin dëshminë e regjistrimit të studimeve të doktoratës;

- e) Kandidatët që janë të punësuar në UIBM duhet të paraqesin vendimin e emërimit të fundit;
- f) Dëshmitë për monografitë, referencat përkatëse për mësimdhënie, tekstet mësimore, pjesëmarrje në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme, mentorime, pjesëmarrje në konferenca shkencore, publikimet shkencore e profesionale brenda kornizës së përcaktuar me Statutin e UIBM dhe rregulloret përkatëse për kategoritë e mësimdhënësve;
- g) Dëshmi nga Gjykata jo më të vjetër se 15 ditë, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë.

2. Kandidatët të cilët nuk janë të punësuar në UIBM, përveç dokumenteve nën pikat a), b), c), dhe f) duhet të sjellin edhe:

- h) Diplomat origjinale ose kopjet e diplomave (bachelor, master/magjistraturë e doktoratë) të vërtetuara nga noteri;
- i) Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit, me rastin e aplikimit për zgjedhje, rizgjedhje apo avancim, duhet ta sjellin vendimin për nostrifikimin (barasvlerën) e diplomës përkatëse (bachelor, master, magjistraturë, doktoratë) ose dëshmitë e aplikimit për nostrifikim;
- j) Kandidatët të cilët pretendojnë të themelojnë marrëdhënie të rregullt pune për herë të parë në UIBM, duhet të sjellin dëshmi nga Gjykata, përmes së cilës dëshmohet që nuk janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- k) Dëshmitë për përvojën e punës të realizuar në institucione dhe programe të akredituara të arsimit të lartë;
- l) Informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë; dhe
- m) Deklaratën me shkrim për gatishmëri të dorëheqjes nga vendi i punës paraprak në rast të emërimit nga Senati.

#### **IV. Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim**

1. Të gjitha emërimet për tituj, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit dhe Rregullores në fuqi për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancimit të personelit akademik në UIBM dhe ndryshim/plotësimit të saj.
2. Avancimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe meritore për të gjitha pozitave.
3. Në rastin e mungesës së vendimit për nostrifikim të diplomës në kohën e aplikimit për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim, kandidati është i obliguar që së paku 3 ditë para se Senati të vendos për lëndën përkatëse, të sjellë vendimin për nostrifikim të diplomës/ave, në të kundërtën kandidatura do të refuzohet.
4. Në kuptim të zbatimit të nenit 6 të Rregullores për të ardhurat e personelit akademik, shtesat për funksione dhe kompensimet tjera në UIBM me

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; [info@umib.net](mailto:info@umib.net); Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1

nr.prot.1704, dt.01.08.2024 kandidatët të cilët pretendojnë të themelojnë marrëdhënie të rregullt pune për herë të parë në UIBM, nuk mund të kenë kontratë tjetër punësimi me normë të plotë brenda apo jashtë Universitetit, andaj nëse janë të punësuar në ndonjë institucion publik apo privat, ndërmarrje publike apo private brenda apo jashtë vendit dhe/apo persona tjerë juridik të cilësdo fushëveprimtari apo status ligjor obligohen që para se të nënshkruajnë kontratë pune me UIBM të sjellin dëshmi për dorëheqje të parevokueshme nga vendi i punës paraprak, në të kundërtën të njëjtit nuk do të mund të nënshkruajnë kontratë pune me UIBM.

5. Anëtarët e personelit akademik sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë të cilët kalojnë në pozitën e bashkëpunëtorëve të jashtëm ose obligohen që të pezullojnë vendin e punës, gjatë periudhës që ushtrojnë poste publike, nuk kanë të drejtë t'i nënshtrohen procedurave të konkursit të rregullt për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim.
6. Kriteri i moshës së përcaktuar si në nenin 171 të Statutit vlen për kandidatët, të cilët aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës dhe do të merret në konsideratë deri në ditën e mbylljes së afatit për aplikim në konkurs. Nëse një (1) kandidat ka qenë i angazhuar në UIBM në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm apo me honorar para moshës së përcaktuar sipas nenit 171 të Statutit, kjo nuk nënkupton që për të njëjtin nuk aplikohet kriteri i moshës së paraparë me Statut në momentin e themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës.
7. Bazuar në Ligjin e Punës në fuqi, kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vjet konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.
8. Në UIBM nuk lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej njësive akademike nëse brenda atyre njësive kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin bashkëshortor, prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
9. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

## **V. Vendimi, periudha e ankimimit dhe e përmbylljes së konkursit**

1. Procedura e votimit në Senat për propozimet e Këshillit të Fakultetit lidhur me emërimin dhe avancimin e anëtarëve të personelit akademik bëhet sipas Rregullores së Punës të Senatit.
2. Anëtari i personelit akademik i cili ka vlerësim pozitiv nga instancat paraprake, por i cili nuk i fiton votat e nevojshme të anëtarëve të Senatit për avancim, mbetet në thirrjen e njëjtë.
3. Ndaj vendimit të Senatit në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimit në dorëzim të njoftimit për vendim mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtrës.

4. Konkursi për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim të personelit akademik duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UMIB-it për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.

5. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit, afati i gjithë procedurës mund të zgjatet maksimum edhe 30 ditë.

6. Nëse konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 4 të këtij neni, atëherë vendet përkatëse të porealizuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së Fakultetit.

7. Kontrata e punës për personelin akademik të zgjedhur për herë të parë në Universitetin e Mitrovicës sipas vendimit të Senatit do të nënshkruhet vetëm nëse për lëndën përkatëse, brenda afatit ligjor, nuk ushtrohet ankesë, respektivisht në rast të ankesës, deri në një vendim përfundimtar të organit kompetent.

## VI. Mënyra e aplikimit

1. Konkursi publikohet në web-faqen zyrtare [www.umib.net](http://www.umib.net)
2. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
3. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në fakultetin përkatës, kurse versioni elektronik në platformën on-line të UIBM linku: [konkursi.personeliakademik2024@umib.net](mailto:konkursi.personeliakademik2024@umib.net)
4. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk ka nevojë të skanohen në tërësi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet), ndërsa për libra dhe monografi të botuar duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi në botim (CIP) ose të dorëzohet vendimi pozitiv i Këshillit Botues për lejebotim.
5. Dorëzimi fizik i aplikacioneve dhe aplikimi përmes platformës on-line do të fillojë nga data **04.10.2024 deri më 18.10.2024**.
6. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartcekur, nuk do të merren në shqyrtim.
7. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit, përkatësisht nga data **04.10.2024 deri më 18.10.2024 ora 16:00**.

